REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT - TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 141/17
Datë/Datum. 29.05.17
PRISHTINE - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit: **"Posta e Kosovës sh.a"**	Kopje:	Paneli Shqyrtues – **OSHP** **Nr. 141/17**
Nga:	Basri Fazliu - Ekspert shqyrtues		
Lënda:	Ekspertiza për lëndën **"Furnizim me material hargjues për zyre për nevojat e PK-së"**, me nr. të Prokurimit: **vetak 17/37/111.**		
Përgjigjeje në ankesë:	**OE- "Infinitt" sh.p.k & N.P.T "Mali-I"**		
Datë	**29.05.2017.**		

Bazuar në nenin 114 të LPP-së ju njoftojmë me Raportin e ekspertizës, lidhur me Ankesën e parashtruar nga OE: **"Infinitt" sh.p.k & N.P.T "Mali-I"** , kundër AK – **Posta e Kosovës sh.a,** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizim me material hargjues për zyre për nevojat e PK-së"** me nr. të Prokurimit: **vetak 17/37/111.**

AK, është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

1x1 Panelit Shqyrtues të OSHP-së.
1x1 Autoriteti Kontraktues.
1x1 Operatorit ekonomik ankues.

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES - TEKNIK

		19.05.2017		22.05.2017		29.05.2017
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të eksp.*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën 15.05.2017, OSHP ka pranuar ankesën me nr. 141/17, e parashtruar nga OE: "Infinitt" sh.p.k & N.P.T "Mali-I", - Prishtinë, kundër AK – Posta e Kosovës sh.a, lidhur me aktivitetin të prokurimit "Furnizim me material hargjues për zyre për nevoja të PK-së" me nr. të Prokurimit: vetak 17/37/111.

Konform nenit 113.1, te LPP-se Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – Posta e Kosovës sh.a

N.111,LPP - Operatori Ekonomik Ankues "Infinitt" sh.p.k & N.P.T "Mali-I"

Pikat e Ankesës nga OE **"Infinitt" sh.p.k & N.P.T "Mali-I"- Prishtinë.**

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:

Neni 6 i LPP-së - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 i LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi.

Neni 10 i LPP-së - Mjetet për promovimin e Transparencës.

Neni 42 i LPP-së - Publikimi i njoftimeve.

Neni 59 i LPP-së - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve.

Neni 65 i LPP-së - Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve.

Neni 72 i LPP-së - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë.

Neni 108/A i LPP-së - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, pika 2.

Rregulli 20.1 në dosjen e tenderit.

Udhëzimi operativ 18.3 i hyrë në fuqi me 01.11.2016.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Autoriteti Kontraktues përkatësisht komisioni vlersues gjatë vlersimit të tenderit nuk ka respektuar dispozitat ligjore të lartëcekura, ne jemi eliminuar padrejtësisht nga procedura e tenderit me arsyetim se janë paraqitur gabime aritmetikore në ofertën tonë më shumë se 2%, kjo nuk qëndron.

Ne pas pranimit të letrës standarde për llogaritje të gabuar me 07.04. kemi ri-kalkuluar listën e cmimeve dhe konstatuam se totali i ofertës sonë është 124,738.35, cmimi i në hapje ka qenë

125.758.37, gabime në cmim kemi 1020.00 euro që është Brenda normes së lejuar 2%, pra komisioni vlersues nuk ka respektuar nenin 59 paragrafin 3 të LPP-së, konform LPP-Nenit 72 ne i kemi dërguar dokumentacion shtesë autoritetit kontraktues (Deklaratë për konfirmimin e cmimeve, faturë formale me disa artikuj) dokumentacion ky të cilin autoriteti kontraktues nuk e ka marë parasysh.

Shtojce. Korrespondencat me AK

Ne me 04.04 kemi kërkuar interpretim nga KRPP se cili cmim duhet të meret për bazë gjatë vlersimit të ofertave, dhe na është kthyer përgjigje se cmimi për njësi me TVSH është cmimi kryesor/dominues në dosjen e tenderit i cili duhet të meret për bazë gjatë vlersimit të ofertave, edhe AK- Posta e Kosovës e posedon këtë informacion pasiqë KRPP me shkrim i ka njoftuar edhe AK se cmimi për njësi me TVSH është cmim i cili duhet të meret për bazë gjatë vlersimit të ofertave.

Shtojce. Interpretimi nga KRPP

Poashtu komisioni vlersues ka shkelur Nenin 6 në bazë të cilit cdoherë autoriteti kontraktues obligohet që fondet/burimet publike të shfrytëzohen në mënyrë sa më ekonomike. Autoriteti kontraktues në këtë rast ka dëmtuar buxhetin e shtetit(fondet publike) përkatësisht PK-së për 4521.35. Ne si pjesmarrës në këtë aktivitet të prokurimit ndihemi të diskriminuar nga autoriteti kontraktues, nuk jemi trajtuar barabartë/drejtë, jemi eliminuar padrejtësisht në këtë mënyrë autoriteti kontraktues përkatësisht komisioni vlersues ka shkelur Nenin 7 të LPP-së.

Ne si pjesmarrës në këtë aktivitet të prokurimit ndihemi të diskriminuar nga autoriteti kontraktues me faktin se në vendim (përgjigjen lidhur me kërkesën për ri-shqyrtim) na ka etiketuar si OE jo-serioz për shkak të ndërprerjes së kontratës "Furnizim me formular të ndryshëm, etiketa, zarfe të ndryshëm, ambalazh për koli, thasë dhe lidhëse të thasëve për nevojat e shërbimit të Postës vendore dhe ndërkombëtare'' me nr të prokurimit: PK/16/038/12, kontratë të cilën nuk e ka respektuar AK- Posta e Kosovës, kontratë në të cilën ne kemi realizuar detyrat dhe përgjegjësitë tona sipas Kushteve të kontratës e nënshkruar mes dy palëve, kemi bërë përpjekje të vazhdueshme për mos ndërprerjen e kontratës, deri te nderprerja e kontratës ka ardhur për shkak se AK-Posta e Kosovës nuk ka respektuar kontratën- PJESA III e kontratës, Neni 20.1- Afatin e pagesës 30-ditë kalendarike, fatura nr. 11.2016/11 e lëshur me 18.11.2016 në vlerë 29,200.00 nuk na është paguar sipas afatit ligjor të cekur në kontratë dhe në planin e menaxhimit 30-ditë kalendarike. Ne disa herë i jemi drejtuar zyrtarit kryesor të prokurimit duke kërkuar sqarim ligjor se cilën pikë të Nenit 65 kemi shkelur që na etiketoni si OE jo-serioz/ i papërshtatshëm, nuk kemi marë përgjigje ligjore. Më shumë detaje gjeni në korrespondencat me AK të cilat ia kemi bashkangjitur ankesës.

Shtojce: Korrespondencat me AK

Vlen të theksohet fakti se pas ndërprerjes së njëanshme të kontratës me 01.02.2017. nga AK-Posta e Kosovës ne kemi marë pjesë edhe një aktivitet tjetër të prokurimit: Titulli: Furnizim me pako të kartonit për nevoja të PK-së, për shkak se nuk kemi qenë oferta më e lirë e përgjegjshme me 21.03 kemi pranuar letrën Standarde per tenderuesin e pasuksesshëm (letër e cila u drejtohet operatorëve të cilët kanë plotësuar të gjitha kërkesat e AK në njoftimin per kontratë dhe në dosjen e tenderit), prandaj edhe njëherë ky fakt demanton pretendimin e zyrtarit kryesor të prokurimit në PK se ne jemi operator joserioz/i papërshtatshëm dhe për periudhën 1 vjeqare AK-ja nuk do të lidhë kontratë me ne. Nëse ne kemi shkelur Nenin 65 të LPP-së është absurd që penalizimi nga pjesmarrja në aktivitetet e prokurimit

në AK- Posta e Kosovës, ky vendim" i AK të zbatohet në mënyrë selektive siq pretendon zyrtari kryesor i prokurimit në PK.

Shtojcë: Letra standarde per tenderuesin e pasuksesshëm

Vlen të theksohet një shkelje tjetër procedurale nga AK, njoftimi për dhënie të kontratës është ngarkuar në sistem me 28.04 ndërsa letrën standarde për tenderuesin e pasuksesshëm/eliminuar e kemi pranuar me 02.05. në ora 15:59, lind dyshimi se AK në mënyrë të heshtur qëllimisht nuk na ka njoftuar me kohë lidhur me eliminimin e kompanisë sonë, në këtë mënyrë ne jemi informuar lidhur me rezultatin e tenderit/fituesin një ditë pa skaduar afati kohor për ankesa dhe në këtë mënyrë periudha per pergaditjen e kërkesës për ri-shqyrtim na është kufizuar/shkurtuar shumë. Me këtë rast AK nuk ka respektuar udhëzimin e KRPP-së lidhur me njoftimet për e-prokurim i cili është lansuar me 02.03, citoj: Autoritetet kontraktuese duhet te sigurohen se së paku ne njërën nga format e cekura me lart (elektronik ose fizik) ofertuesit janë njoftuar dhe/ose kane pranuar njoftimin ne fjale. Pra, konfirmimi nga ana e palëve (operatorit ekonomik dhe/ose autoritetit kontraktues) i pranimit te njoftimit është i domosdoshëm. Ne asnjë rrethanë nuk do te konsiderohet i vlefshëm për çështje ligjore njoftimi i cili nuk është konfirmuar me dëshmi se i është dorëzuar palës ne cilën do forme te komunikimit. (përmes platformës, me shkrese dhe/ose e-mail).

Autoriteti kontraktues ka bërë shkelje ligjore- procedurale me faktin se pas pranimit të Kërkesës për ri-shqyrtim nuk ka bërë pezullimin e aktivitetit të prokurimit konform LPP-së, nenit 108/A, pika 2. Autoriteti Kontraktues ka shkelur LPP, duke mos respektuar Rregullin 20. 1 në dosjen e tenderit dhe Udhëzimin operativ 18.3 i hyrë në fuqi me 01.11.2016 pasiqë në vendimshqyrtimin e kërkesës për ri-shqyrtim thuhet se AK nuk ka lejuar më shumë se tre (3) numra pas presjes dhjetore që është në kundërshtim me dispozitat/rregullat ligjore të lartëcekura pasiqë bazuar në udhëzimin operativ 18.3 AK në rast se lejon më shumë se dy(2) numra pas presjes këtë duhet të cekë decidivisht në dosjen e tenderit, gjë që nuk e ka bërë/lejuar Posta e Kosoves në dosje.

Shtojce. Vendimi i AK-së.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP :	02.02.2017
Lloji i procedurës së aplikuar:	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:	Furnizim/vlerë e madhe
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave, pas szgjatjes se afatit,	28.03.2017
Afati i parapare per hapje te ofertave, pas zgjatjes,	28.03.2017
Data e njoftimit per dhenje te kontrtes	01.05.2017
Kriter për dhënien e kontratës:	Tenderi përgjegjshëm /çmimi më i ulë.

Kriteret për vlerësim

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

Operatori ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës, Ligji Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, i cili mund të shkarkohet nga faqja e internetit http://krpp.rks-gov.net/

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
a)Një deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar ne dosjen e tenderit. Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërise do të kërkohen nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit te këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet Dokumentet te cilat do te kërkohen si dëshmi për përmbushje te kërkesave te pranueshmërise para shpërblimit te kontratës janë me se vijon: a) Për situatën referuar nenit 65, paragrafi 3, nen-paragrafi 3.1, 3.2, 3.3, 3.4, 3.5 dhe 3.6 dhe paragrafi 4, nen –paragrafi 4.1, 4.2 dhe 4.4, Vertetimi i leshuar nga gjykata kompetente apo autoriteti administrative të vendit të themelimit të tenderuesit. b) Për situatën referuar nenit 65, paragrafit 4, nen-paragrafit 4.9 (kontributi i sigurimit social), 4.10 dhe 4.11, certifikate e lëshuar nga autoriteti kompetent apo operatori publik që një situate tillë nuk ekziston. c) Vërtetimi i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës. Në lidhje me dispozitat e tjera të përcaktuara në Nenin 65 si dhe në rastin kur lëshimi i dokumenteve dhe certifikatave që referohen më lart është i pamundshëm për arsye objektive, apo kur dokumentet nuk mbulojnë të gjitha rastet për të cilat është nxjerrë dëshmia, një deklaratë nën betim nga tenderuesi mund të pranohet si dëshmi e mjaftueshme

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:
a)Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin professional,komercial, dhe /apo regjistrine nderrmarjeve në vendin e juaj të themelimit; b)Regjistrimi i numrit fiskal
c)Regjistrimi I TVSH-së

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:
N/A

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:
a)Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku 2(dy) kontrata të natyres së njëjtë në 3 (tri) vitet e fundit

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
a)Kopja e certifikates se regjistrimit te biznesit te operatorit ekonomik ne regjistrat professional, komercial dhe te korporatave ne vendin e tij të themelimit, ose nëse nuk është e mundshme, deklaratën nën betim lidhur me regjistrimin e tille.
b)Kopja e certificates së numrit fiskal.
c)Kopja e certificates së TVSH-së

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
N/A

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
a) Një listë te furnizimeve të realizuara në 3 vitet e fundit ,duke saktësuar: produktet e përfshira shumen e kontratës, datën dhe pranuesit (referenca per kontratat e realizuara apo raportet e pranimit).

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatoret ekonomik	Vendi	Çmimi total për njësi €
1.	INFO SOFT OFFICE	PRISHTINË	140,850.98€
2.	MEDIATECH&PRINT	PRISHTINË	142,996.20€
3.	EUROPRINTY SHPK	PRISHTINË	149,094.20€
4.	NTG BLENDI	PRISHTINË	133,748.38€
5.	GRAFO-LONI SH.P.K	PRISHTINË	129,100.88€
6.	OFFICE 1 KOSOVA	PRIZREN	123,993.16€
7.	ART SH.P.K	PRISHTINË	164,963.41€
8.	NTP VLORA	PRISHTINË	136,144.46€
9.	NTL RILINDJA	SKENDERAJ	130,138.88€
10.	INFINITT SH.P.K	PRISHTINË	125,758.37€
11.	NT AGIMI-DE	DEÇAN	138,036.59€

Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve me datën: 28.03.2017, *konstatohet se në hapjen e ofertave ka marrë pjesë NJëmbëdhjetë (11) OE në këtë aktivitet të prokurimit, ku është lexuar emri i operatorit ekonomik, vendi, çmimi dhe ndonjë vërejtje nëse është paraqitur. Procesverbali i hapjes është nënshkruar nga anëtarët e komisionit të hapjes pranë AK-së.*

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- - Kryetar i komisionit –Fllanza SHABI
- - Anëtar i komisionit - Petrit KASTRATI
- - Anëtar i komisionit – Aulona ISMAILI

Data e mbarimit të vlerësimit: 24.04.2017

Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....26.04.2017

Raporti i komisionit vlerësues:

Komisioni vlerësues i Autoritetit kontraktues Posta e Kosoves sh.a, operatorin ekonomik NTGI Grafo Loni sh.p.k, me seli në Prishtinë, shpall fitues pasi ka ofertuar me çmim më të lirë dhe dokumentacion të përgjegjshëm, andaj rekomandon zyren e prokurimit të shpërblej me kontratë.

Analiza dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues - (N. 306)

Në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të lëndës së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, bazuar në dokumentacionin që kanë pasur në dispozicion eksperti shqyrtues jep mendimin si në vijim:

Eksperti shqyrtues sqaron:

Autoriteti kontraktues gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedur të hapur, kontrat për furnizim me vlerë të madhe, kriter për dhënie të kontratës ka qenë: "Tenderi përgjegjshëm me çmimi

më të ulët". I pakënaqur me njoftimin për dhënien e kontratës, të datës 11.04.2017, për këtë aktivitet të prokurimit, operatoret ekonomik ankues, ka parashtruar ankesë në OSHP me datë 28.04.2017, me pretendimet ankimore se janë shkelur neni:

Neni 6 i LPP-së - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 i LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi.

Neni 10 i LPP-së - Mjetet për promovimin e Transparencës.

Neni 42 i LPP-së - Publikimi i njoftimeve.

Neni 59 i LPP-së - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve.

Neni 65 i LPP-së - Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve.

Neni 72 i LPP-së - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë.

Neni 108/A i LPP-së - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, pika 2.

Rregulli 20.1 në dosjen e tenderit.

Udhëzimi operativ 18.3 i hyrë në fuqi me 01.11.2016.

Ne interpretim të asaj që u tha më lartë, po sqarojmë se i kemi shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndes, konkretisht ato që lidhen me zbatim të vendimit të lartë përmendur (pretendimeve ankimore) dhe atë si në vijim:

Pretendimi ankimor 1,

Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket arsyes të eliminimit të OE ankues në bazë të nenit 65 të LPP-së, si OE jo-serioz, nga ana e AK-së në lidhje me mos realizimin e kontratës në vitin 2016, me nr.prok.PK/16/038/121,

Eksperti shqyrtues vlerëson se NUK mund të eliminohet një OE nga pjesëmarrja në një aktivitet të prokurimit për derisa NUK është konstatuar nga një gjykatë kompetente, agjenci administrative ose organizatë për zbatimin e standardeve të sjelljes profesionale, se është sjellë në mënyrë joprofesionale, në rastin konkret Autoriteti kontraktues nuk ka dëshmuar ndonjë dokument se i njëjti OE është shpallur jo-serioz në harmoni me nenin 65, paragrafi 3-4 të LPP-së.

Poashtu në lidhje me pretendim ankimor të parashtruar nga OE ankues, sa i përket AK-së Posta Kosoves, se në një aktivitet të mëhershem, i njëjti OE, nuk është trajtuar si OE jo-serioz në bazë të nenit 65 të LPP-së, **Eksperti shqyrtues vlerëson** se qëndron ky pretendim ankimor duke u bazuar në letrën standarde e dt. 21.03.2017, sa i pëket aktivitetit të prokurimit "Furnizim me pako të kartonit për nevoja të PK-së", të ofruar nga OE ankues, ku dëshmohet se OE kishte marrur pjesë në këtë aktivitet të prokurimit dhe është shpallur si OE i pasukseshëm, nuk ishte cilësuar si OE jo-serioz si në rastin konkret.

Pretendimi ankimor 2,

Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket arsyes të eliminimit të OE ankues nga ana e komisionit vlerësues në lidhje me çmimet,

Eksperti shqyrtues bazuar në listen e çmimeve të ofertës së OE ankues, vlerëson se qëndron pretendimi ankimor, njëherit arsyetimi i dhënë nga ana e komisionit vlerësues është i pabazuar, për faktin se OE ankues ka ofruar çmime për njësi me TVSH, në përshkrimin e çmimeve në gjithsej pozicionet pozicionet OE ankues ka vendosur çmime për njësi me TVSH, si dhe çmimin total me TVSH, duke shumëzuar me

sasit e vendosura, gjatë shiqimit të paramases dhe analizimit të çmimeve në paramasë rezulton se ndryshimi në çmimin total NUK e kalon vlerën prej 2% të gabimit aritmetik siç pretendon autoriteti kontraktues.

Eksperti shqyrtues gjatë ekzaminimit të ofertës financiare të OE ankues vlerëson se në rastin konkret NUK kemi të bëjmë me ofertë financiare manipuluese për qka edhe parashihet me nenin 18.3 të Udhëzuesit Regullativ për Prokurim Publik, që të sanksionohen OE që ofroj çmime manipulative duke përdor çmime shumë shifrore pas pikës dhjetore siç kemi pasur në praktikat e kaluara, në rastin konkret lidhur me këtë ofertë financiare rezulton se asnjë pozicion NUK është ofruar me çmim 3 shifror pas pikës dhjetore, edhe pse furnizimet të këtyre produkteve kemi të bëjmë me çmim të ulët të produktit.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në s'qarimet e lartë cekura vlerëson se komisioni vlerësimit gjatë vlerësimit, ekzaminimit të ofertës të OE ankues NUK ka vepruar në harmoni me nenin 59 të LPP-së, nenin 6,7 dhe 65 të LPP-së.

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues:

Eksperti shqyrtues duke u mbështetur në vlerësimet e lartë cekura, i rekomandon panelit shqyrtues që të APROVOJ si të BAZUARA ankesën OE "INFINITT", me seli në Prishtinë, për këtë aktivitet të prokurimit dhe njëherit të ANULOJ vendimin "Njoftimi për dhënien e kontratës, i datës 01.05.2017, me titull: "Furnizim me material hargjues për zyre për nevoja të PK-së", me nr. të Prokurimit: vetak 17/37/111 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Posta e Kosovës sh.a, dhe ky aktivitet i prokurimit të kthehet në RI-VLERËSIM.